



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.56/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Laziq dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të vendosjes se posterit në hapësirat publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kështu që Koalicioni PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,100.00 (dymijë e një qind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit

### **A r s y e t i m**

Me datën 05.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës(KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017, ka vërejtur se në rrugën Xheladin Rekaliu të Prishtinës në afërsi të konvikteve të studentëve, monitoruesit e ynë ka hasur në poster të kandidatë për deputet të kuvendit nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA për një tubim elektorale të vendosur në hapësirat publike gjegjësisht në pritore të autobusit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1,pika b),të LPZ-së duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur posterin në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur<sup>2</sup> (dy)fotografin të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017, Koalicioni PDK-AAK-NISMA, thekson se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivistët të painformuar mirë me rregullat zgjedhore, respektivisht me Rregullën Zgjedhore nr. 11/2013 neni 4.1,(b). Edhe përkundër kësaj koalicioni ka marrë masat e duhura për të përmirësuar shkeljen e pretenduar sipas Anr. 56/2017. Koalicioni ka evituar shkeljen dhe të gjitha këto veprime të ndërmarra provohen me dëshmi(fotot) që janë pjesë e përgjegjës. Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatëve për deputet në fushatën zgjedhore të koalicionit PDK-AAK-NISMA, janë vendosur në hapësirat publike e

cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga koalicioni në fjalë janë vendosur në hapësirën publike konkretisht në pritore të autobusëve. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni PDK-AAK-NISMA, në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posterët e kandidatëve për deputet nga ky koalicion janë vendosur në hapësirë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se subjekti politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.56/2017 më datën 06.06.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.